

Protesta sapo ka filluar nuk ka mbaruar



Presidenti i BSPSH Gëzim Kalaja i bëri thirrje kryeministrit të dëgjojë zërin e qytetarëve të cilët i ka zhytur në mjerim

Mijra njerëz në shesh. Fotot e tregojnë qartë madhësinë e kësaj proteste. Ashtu siç ishte paralajmëruar marshimi ka nisur rreth orës 12:00 nga sheshi "Skënderbej" në kryeqytet, për t'u ndalur përpara godinës qeveritare. Protestues nga e gjithë Shqipëria zbritën më 22 nëntor në shesh për të kundërshtuar rritjen e çmimit të energjisë, rritjen e taksave, papunësinë, varfërinë, rritjen e pasigurisë në vend etj.





